



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.7.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
MALISHEVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, Qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Malishevës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Edon Kabashi Udhëheqës i Ekipit dhe Elvir Krasniqi, Anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Luljeta Morina.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	26
5 Qeverisja e mirë.....	27
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	30
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	32
Shtojca III: Komentet e komunës në gjetjet e raportit të auditimit	38
Shtojca IV: Letër konfirmimi	40

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Malishevës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 05/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Malishevës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes


Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, përveç keq klasifikimit të shpenzimeve në vlerë prej 178,035€, të cilat ishin realizuar dhe raportuar gabimisht si investime kapitale, derisa për nga natyra ato i takonin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe subvencioneve dhe transfereve.

Theksim i çështjes

Si theksim i çështjes dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë 59,885€, ishin buxhetuar, realizuar dhe raportuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Komenti i Kryetarit të Komunës për çështjen që nuk jemi pajtuar, është dhënë në detaje në Shtojcën III.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës së Malishevës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Malishevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion të kualifikuar

Ne kemi kualifikuar opinionin e auditimit për faktin se:

- Shpenzimet në 28 raste në vlerë 176,445€ të cilat gjithashtu për nga natyra i përkasin mallrave dhe shërbimeve, ishin paguar dhe raportuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale; dhe
- Shpenzimi në vlerë 1,590€ të cilat për nga natyra i përkasin subvencioneve dhe transfereve, ishin realizuar dhe raportuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale.

Keq-klasifikimi në vlerë totale 178,035€, ishte materiale, andaj ne e kemi kualifikuar opinionin e auditimit. Kjo vlerë kishte ndikim në dy pasqyrat kryesore si dhe të shpalosjet.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të organizatave buxhetore në Kosovë, ZKA është e pavarur nga komuna e Malishevës dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

Theksimi i çështjes

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se pagesat për investime kapitale në vlerë 59,885€ (tri pagesa), ishin buxhetuar¹ dhe realizuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale, derisa sipas natyrës së shpenzimeve ato i takonin kategorisë mallra dhe shërbime. Opinioni ynë nuk është i kualifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Malishevës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe

¹ Këto shpenzime ishin aprovuar me ligjin e buxhetit të vitit 2017 si investime kapitale, por projektet e paraqitura në tabela, nuk përmbushin kriteret të trajtohen si projekte kapitale.

vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Dorëzimin e raporteve të rregullta tremujore në Kuvend Komunal; dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë.

Në kontekst të cilësisë së PFV-ve, një numër i këshillave që i kemi dhënë në Memorandumin e Auditimit të datës 24/11/2017 janë adresuar gjatë procesit të përgatitjes të tyre.

Në PFV-të e dorëzuara në muajin janar 2018 ishin prezantuar disa gabime, të cilat menaxhmenti i kishte përmirësuar në PFV-të e korrigjuara të datës 19/03/2018, me përjashtim të çështjeve të prezantuara të opinionit të auditimit.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, përveç keq-klasifikimeve në kategoritë ekonomike joadekuate.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimi:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Kualifikim dhe Theksim të Çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve. Në këtë aspekt, duhet të sigurojë se të gjitha shpenzimet buxhetohen, realizohen dhe raportohen në kategoritë ekonomike adekuate për të prezantuar një pasqyrë të drejtë të tyre.

Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme. Edhe kërkesat tjera për raportim të përmbushen konform kërkesave rregullative.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Edhe pse Komuna e Malishevës ka bërë një numër përmirësimesh, ende mbetin një numër fushash ku nevojiten zhvillime të rëndësishme. Çështjet e ngritura nga auditimi i vitit të kaluar nuk janë shqyrtuar sa duhet nga menaxhmenti.

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat nuk ishin efektive dhe nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur, megjithatë fushë me shqetësuese vazhdon të mbetet prokurimi, për shkak se nuk janë zbatuar sa duhet kërkesat e LPP-së. Përmirësime kërkohet kryesisht në menaxhimin e projekteve kapitale, si dhe te obligimet.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	12,866,847	13,090,604	12,470,490	12,359,739	12,004,214
Granti i Qeverisë -Buxheti	11,769,705	11,808,443	11,737,632	11,601,601	11,243,402
Të bartura nga viti paraprak ³ -	-	177,366	172,473	125,568	222,180
Të hyrat vetjake ⁴	1,097,142	1,097,142	554,140	579,272	458,203
Donacionet e brendshme	-	2,183	1,770	4,651	4,168
Donacionet e jashtme	-	1,440	730	48,647	76,261
Huamarrja	-	4,030	3,745	-	-

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

³ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpënuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 223,757€. Kjo rritje është rezultat i grantit qeveritar për 38,738€, të hyrave të bartura nga viti paraprak 177,366€, huamarrja 4,030€, si dhe donacioneve të brendshme për 3,623€.

Në vitin 2017, komuna ka shpenzuar rreth 95% të buxhetit final ose 12,470,490€, vlerë përafërsisht e njëjtë krahasuar me vitin 2016 (96%).

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	12,866,847	13,090,604	12,470,490	12,359,739	12,004,214
Pagat dhe Mëditjet	7,694,744	7,739,587	7,736,432	7,696,945	7,442,409
Mallrat dhe Shërbimet	816,312	829,839	773,758	686,114	793,343
Shërbimet komunale	305,000	305,000	303,820	300,174	303,918
Subvencionet dhe Transferet	65,767	65,767	65,526	91,822	79,860
Investimet Kapitale	3,985,024	4,150,411	3,590,954	3,584,684	3,384,684

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 44,843€ është rezultat i të hyrave të bartura në vlerë 5,785€ dhe mbulimi i deficiteve në paga nga ana e Ministrisë së Financave në vlerë 39,058€;
- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime 13,527€ është rezultat i të hyrave të bartura në vlerë 9,497€ dhe financimeve nga huaja në vlerë 4,030€; dhe
- Rritja e buxhetit për investime kapitale për 165,387€ është rezultat i të hyrave të bartura 162,146€ dhe 3,241€ nga donacionet e bartura.

Realizimi i buxhetit përgjithësisht është në nivelin e pritur, megjithëse buxheti për investime kapitale ka nevojë të përmirësohet, andaj ne inkurajojmë menaxhmentin e komunës që në vitin 2018 të përmirësojnë menaxhimin e buxhetit në këtë kategori.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2017 ishin në vlerë 572,434€. Të hyrat janë realizuar kryesisht nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, të hyrat nga qiraja, taksa administrative, etj. Përkundër përmirësimeve të bëra, ekziston nevoja për përmirësim të mëtejme në disa procese dhe kontrole që kanë të bëjnë me planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave, me qëllim të rritjes së të hyrave dhe sigurimin e saktësisë dhe plotësisë së raportimeve.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,097,142	1,097,142	572,435	739,284	586,355

Të hyrat e planifikuara në vitin 2017 ishin 1,097,142€ por ishin realizuar 572,435€ apo 52%, që krahasuar me vitin paraprak kishte rënie rreth 13%. Realizimi i ulët i të hyrave ka ndodhur si pasojë e planifikimit të dobët të të hyrave. Përpos të hyrave të prezantuara në tabelë, komuna kishte edhe të hyra indirekte në vlerë 69,477€⁵, të cilat janë mbledhur nga institucionet qendrore.

Çështja 2 – Nivel i ulët i realizimit të të hyrave

E gjetura Komuna nuk kishte bërë analiza dhe vlerësime të sakta në procesin e planifikimit të të hyrave për vitin 2017. Si pasojë, vetëm 52% e buxhetit ishte realizuar. Niveli i ulët i realizimit të të hyrave shkakton mungesën e fondeve për financimin e projekteve të planifikuara.

Rreziku Planifikimi ambicioz dhe mungesa e mekanizmave për mbledhjen e të hyrave të planifikuara do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës, më pak shërbime, apo projekte për qytetaret. Mungesa e fondeve gjithashtu rrezikon edhe rritjen e obligimeve duke ngarkuar buxhetet e viteve vijuese.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të sigurojë që plani i të hyrave është i bazuar në analiza dhe vlerësime të sakta nga departamentet përkatëse që i grumbullojnë ato, si dhe performanca buxhetore (në grumbullimin e të hyrave) të monitorohet në mënyrë sistematike, në baza mujore për të përmirësuar nivelin e realizimit të tyre. Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të rishikohet në buxhetin final.

⁵ Gjobat/dënimet e Policisë së Kosovës në trafik në vlerë 57,047€ dhe Gjobat/dënimet nga Gjykata në vlerë 12,430€.

Çështja 3 – Parregullsi në menaxhimin e tatimit në pronë

E gjetura Komuna nuk kishte arritur të kryej verifikimin (ri anketimin) e 1/3-tës së pronave të paluajtshme siç kërkohet me Ligjin për Tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ në fuqi me qëllim të përditësimit të shënimeve ekzistuese. Sipas regjistrit të tatimit në pronë, komuna ka 11,890 prona komunale të regjistruara, ndërsa gjatë vitit 2017 ka bërë verifikimin e vetëm 2,438 pronave, ose 20% të tyre.

Me tutje, sipas Ligjit mbi tatimin në pronë, neni 9, ceket se çdo person fizik, i cili më datë 1 mars ose para 1 marsit të një periudhe tatimore vendos se prona ose njësia e banimit i shërben si vend kryesor për banim, i lejohet zbritja prej 10,000€ nga vlera e tatueshme e pronës. Në dy raste, ne identifikua se tatimpaguesit posedonin dy apo më tepër prona të regjistruara si banim kryesor dhe për secilën është aplikuar zbritja prej 10,000€. Mangësitë e tilla lidhen direkt me pamundësinë e komunës për të bërë verifikimin e pronave dhe për të identifikuar problemet.

Rreziku Vlerësimi i ultë i pronave reflekton me të dhëna/ informata të mangëta dhe jo të plota mbi pronën e tatueshme aktuale. Gjithashtu komuna rrezikon kalkulim të pasaktë të të hyrave, ngarkesa jo adekuate tatimore dhe me pak të hyra nga kjo kategori. Mos aplikimi i ngarkesave sipas kërkesave ligjore të tatimit në pronë rrit rrezikun që të hyrat prej kësaj kategorie të jenë më të ulëta.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar që bëhet verifikimi i 1/3-tës të pronave, në mënyrë që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota dhe të maksimizohen përfitimet nga kjo e hyrë. Veprime shtesë duhet të ndërmerren që të siguroj se zbritjet për 10,000€ aplikohet vetëm për vendbanimet kryesore.

Çështja 4 - Vonesa në arkëtimin e qirasë

E gjetura Komuna nëpërmes kontratës ka dhënë në shfrytëzim afatshkurtër, me qira “Pishinën publike në fshatin Banjë”. Sipas kontratës, pagesa e qirasë, për periudhën një vjeçare në vlerë 22,117€ duhet të paguhet jo më larg se deri me 31/12/2017. Deri me këtë datë, komuna nuk ka arkëtuar vlerën e plotë sipas kontratës. Arkëtimi ishte në vlerë 19,450€ me diferencë 2,667€.

Rreziku Menaxhimi i dobët i kontratave për pronat e dhëna me qira si dhe mos gatishmëria për të ndërmarrë masa efikase për inkasimin e të hyrave nga to, rritë rrezikun e mungesës së fondeve për financimin e projekte kapitale të planifikuara.

Rekomandimi 4 Kryetari të siguroj një menaxhim efektiv të kontratave të qiradhënies dhe të vendos mekanizma efikas për realizimin e të hyrave konform kushteve të kontraktuara, përkatësisht zbatimin e afateve për arkëtimin e mjeteve nga qiraja.

Çështja 5 – Ngarkese tarifore e parregullt për anëtarësimin vjetor

E gjetura Sipas rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2017, përcaktohet tarifa për anëtarësim vjetor të lexuesve në bibliotekën komunale, në vlerë 1€ për një vit. Ne testuam raportet e muajit janar dhe korrik 2017, dhe vërejtëm se anëtarësimi vjetor i lexuesve në bibliotekën komunale është ngarkuar me tarifa vjetore të ndryshme nga 1€, 2€ dhe 3€. Kjo ka shkaktuar paqartësi në grumbullimin e tyre si dhe trajtim jo të barabartë për qytetaret e komunës.

Rreziku Komuna ka bërë inkasime të tarifave pa ndonjë bazë të qartë ligjore. Mos inkasimi i të hyrave sipas rregullores në fuqi, ndikon që qytetarët të ngarkohen me shuma më të larta nga sa parashihet me rregulloren aktuale në fuqi dhe kjo mund të dëmtoj kredibilitetin e komunës.

Rekomandimi 5 Kryetari duhet të sigurojë se ka shqyrtuar rastin e mbingarkesave të qytetarëve mbi vlerën e përcaktuar me tarifën e rregullores, si dhe të siguroj që të hyrat e inkasuara mbi vlerën e përcaktuar me rregullore t'i kthej të qytetarët. Me tutje të sigurojë kontrolle adekuate mbi menaxhimin dhe raportimin e tyre.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë më: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqesin në mes të formularëve; rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin më thesar. Shpenzimet për paga gjatë vitit 2017 ishin 7,736,432€ apo rreth 100% e buxhetit të planifikuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i burimeve njerëzore ka për qëllim koordinimin e aktiviteteve të organizatës për të siguruar funksionimin e sistemit në përputhje me politikat e administratës komunale dhe të kuvendit komunal, të cilat zbatohen në gjithë organizatën.

Çështja 6 – Menaxhim jo adekuat i dosjeve/të dhënave të personelit

E gjetura Komuna nuk kishte arritur ende të kompletoj dosjet e personelit në përputhje me Rregulloren Nr. 03/2011 mbi dosjet dhe regjistrin qendror për shërbyesit civil”.

- Në dy raste, në dosjet e shërbyesve civil mungonin dokumentet si: certifikata e lindjes, shtetësisë, dëshmitë e punësimit të mëparshëm përfshirë referencat, si dhe vlerësimi i aplikacionit dhe vërtetimet se punonjësit nuk janë nën hetime. Përpos tyre në njërin nga dosjet mungonin edhe formularët e aplikimit, vlerësimi i punës dhe forma e pushimit vjetor; dhe
- Për punonjësit e arsimit dhe shëndetësisë nuk ka rregullore për menaxhimin e dosjeve të personelit. Madje në 14 raste dosjet e personelit për këta zyrtar nuk ishin të kompletuara. Në shumicën e tyre mungonin dokumentet si: letërnjoftimi, certifikata e lindjes, shtetësisë, format e pushimit vjetor, vërtetimet se punonjësit nuk janë nën hetime, vlerësimet e punës etj.

Mangësitë e identifikuar tregojnë vlerësim jo adekuat të këtij procesi nga ana e komunës, për plotësimin dhe mirëmbajtjen e dosjeve.

Rreziku Mos azhurnimi i dosjeve dhe mos kompletimi me dokumentacionin e nevojshëm rrit rrezikun në menaxhim jo adekuat të stafit dhe reflekton me parregullsi dhe mungesë të informatave për stafin e punësuar.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë hapa konkret për përmirësimin e kontroleve mbi dosjet e personelit në mënyrë që të gjitha dosjet të jenë të kompletuara me dokumentacionin e nevojshëm. Kompletimi i dosjeve të behët brenda një afati tre mujor pas pranimit të këtij raporti.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra, shërbime dhe shpenzime komunale në vitin 2017 ishte 1,134,839€. Prej tyre janë shpenzuar 1,077,578 (773,758€ për mallra dhe shërbime dhe 303,820€ për shpenzime komunale), ose 95% të buxhetit.

Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet për komunal, udhëtim, telekomunikim, blerje e mobileve dhe pajisjeve, derivate dhe lëndë djegëse, shërbime të regjistrimit dhe sigurimit, mirëmbajtje, etj.

Çështja 7 – Menaxhim jo adekuat i te angazhuarve përmes kontratave për shërbime të veçanta

E gjetura Sipas Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil (nenit 12 pika 4), emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Nga 46 të angazhuarit përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta, tetë prej tyre janë për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj, qysh nga viti 2016, si dhe angazhimi i tyre ishte bërë pa procedura të thjeshtësuara të rekrutimit. I gjithë stafi ishte i angazhuar për pozita të rregullta të punës. Për më tepër asnjëri prej të angazhuarve nuk i është ndalur tatimi në burim, siç përcaktohet me Ligjin Nr. 05-L-028. Sipas zyrtareve komunal, mangësitë e identifikuar, janë pasojë e mungesës së stafit për programet e përhershme dhe aprovimit të kufizuar të vendeve të punës krahasuar me kërkesat.

Rreziku Mbulimi i pozitave me marrëveshje të përkohshme rezulton me performancë dhe monitorim të dobët të stafit dhe rritë pasigurinë nëse në pozitat e tilla është angazhuar stafi adekuat. Mungesa e konkurrencës së mirëfilltë dhe cilësia e shërbimeve të ofruara mund të jetë e nivelit të dobët dhe objektivat e organizatës të mos arrihen. Gjithashtu neglizhenca e komunës për mbajtjen e tatimit në burim, rrit rrezikun që komuna të jetë subjekt i ndëshkimeve nga autoritetet tatimore.

Rekomandimi 7 Kryetari duhet të sigurojë se punonjësit përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Angazhimi të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore përmes një procesi konkurrues dhe transparent dhe periudha e angazhimit të bëhet në kuadër të afateve të parapara me ligj. Ndërsa për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave. Me tutje për të gjithë të angazhuarit me marrëveshje për shërbime të veçanta duhet të mbahen tatimet në burim dhe kontributet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Çështja 8 – Mangësi në furnizimin me derivate

- E gjetura** Bazuar në kontratën për shpenzimet e derivateve, çmimi i premiumit ishte vetëm 0.001€, çmim jashtëzakonisht i ulët. Nëse e krahasojmë me vlerën e parashikuar të kontratës 90,000€, fitimi total i operatorit ekonomik do të ishte vetëm 90€. Për me tepër komuna nuk kishte ndonjë mekanizëm për vërtetimin e kalkulimit të çmimit të berzës për furnizim me derivate. Paguesa në vlerë 7,750€ për furnizim me karburante, ishte bazuar vetëm në një dokument (faturë) të ofruar nga kontraktuesi për kalkulimin e çmimit për karburant i cili nuk parashihte premiumin. Si rrjedhojë çmimet e paguara mund të jenë me të larta në raport me çmimin e kontraktuar.
- Rreziku** Pagesat e pa kontrolluara duke mos siguruar dëshmi reale për çmimin e berzës, mund të rezultojnë me faturim të mbivlerësuar dhe dëmtim të buxhetit.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet të sigurojë mekanizma të kontrollit, që para lëshimit të pagesave për furnizim me karburante të vërtetohet çmimi i berzës në mënyrë që pagesa të jetë reale dhe mbështetur në dëshmi.

Çështja 9 - Lidhja e kontratës pa procedura të prokurimit

- E gjetura** Komuna kishte hyrë në marrëveshje bashkëpunimit për kontratën “Transporti i nxënësve të shkollave të mesme” në vlerë 23,285€, pa zhvilluar procedura të prokurimit. Ky shërbim është kontraktuar në mes të komunës dhe operatorit ekonomik sipas një marrëveshje që ka lidhur drejtori i drejtorisë për shërbime publike me operatorin ekonomik. Kjo për shkak të kontrolleve të dobëta dhe neglizhencës së komunës.
- Rreziku** Mos aplikimi i procesit të prokurimit, zvogëlon transparencën për shpenzimin e parasë publike dhe komuna mund të marrë shërbime me çmime jo të favorshme (konkurrese) që reflekton në shpenzimin e parregullt të buxhetit për këtë kategori.
- Rekomandimi 9** Kryetari i Komunës të sigurohet që është duke u aplikuar Ligji i Prokurimit Publik me qëllim që blerja e shërbime të kontraktohet duke u bazuar në konkurrencë.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 65,767€. Prej tyre në 2017 janë shpenzuar 65,526€ apo afro 100% e buxhetit të planifikuar. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me mbështetje të aktiviteteve bujqësore, kulturore, sportive, bursa për studentë dhe ndihma momentale.

Çështja 10 - Dobësi në ndarjen e subvencioneve

E gjetura Te kategoria e subvencioneve dhe transfereve, ne identifikuam parregullsi si në vijim:

- Sipas rregullores Kryetari ka të drejtë të aprovoj subvencione vetëm deri në 1,000€. Çdo kërkesë mbi vlerën 1,000€ për persona juridik duhet të aprovohet nga kuvendi. Subvencionimi i shoqatës së bizneseve të Malishevës në vlerë 7,600€, është bërë me vendim të kryetarit, pa aprovim të kuvendit. Me tutje sipas rregullores për ndarje të subvencioneve dhe transfereve, çdo kërkesë mbi 500€ për persona fizik duhet të aprovohet nga kuvendi komunal. Në një rast me vendim të Kryetarit janë mbuluar shpenzimet për shërim, në vlerë prej 800€;
- Në një rast nuk janë plotësuar kriteret e konkursit nga përfituesi i bursës komunale në vlerë prej 150€. Sipas kriterit të vendosur në konkurs, kërkohet që dy apo me shumë anëtarë të familjes të jenë student të rregullt, mirëpo komuna nuk kishte dëshmi mbi përmbushjen e këtij kriteri nga përfituesi; dhe
- Komuna ka bërë subvencionimin e fermerëve për “Ndërtim të stallave dhe furnizim me nga pesë lopë”. Në këtë proces kishin aplikuar 39 fermer, prej tyre 16 kanë përmbushur të gjitha kriteret, megjithatë komisioni ka përzgjedhur vetëm 10 përfitues. Ne nuk kemi gjetur dëshmi se si është bërë përzgjedhja e 10 përfituesve nga 16 pretendentët që kishin përmbushur të gjitha kriteret.

Rreziku Dhënia e subvencioneve pa respektuar kriteret e vendosura dhe rregulloren e brendshme komunale, paraqet rrezik që kontrollet e brendshme të anashkalohen dhe subvencionet të mos arrijnë objektivat e synuara.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të siguroj se vendimet e nxjerra janë në harmoni me rregulloren e brendshme komunale si dhe të forcoj kontrollet për dhënien e subvencioneve duke ofruar dëshmi se subvencioni ka arritur qëllimin dhe përfituesin e merituar.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,150,411€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 3,590,954€. Ato kanë të bëjnë me shpenzime për rregullim të infrastrukturës, ndërtim i rrugëve dhe shkollave, pajisje dhe përmirësime të ndryshme të pasurive kapitale.

Çështja 11 - Inicimi i procedurave të prokurimit pa plan ekzekutiv të ndërtimit

E gjetura Në tri raste komuna ka iniciuar procedurat e prokurimit, pa projekt ekzekutiv të ndërtimit siç kërkohet me paragrafi 10 të nenin 28 të LPP-së, si:

- Te kontrata “Ndërtimi i shkollës fillore në Llozicë” komuna ka përdorur projektin e shkollës së Shkozës pa bërë adaptimin e atij projekti. Si pasojë e mungesë së një projekti adekuat për ndërtimin e këtij objekti, komuna është detyruar të bëjë aneks-kontratë për realizimin e punëve;
- Te kontrata “Ndërtimi dhe asfaltimin e rrugëve nëpër fshatra të Malishevës” aktiviteti i prokurimit është zhvilluar duke u bazuar vetëm në paramasë dhe paralogari të përgatitura nga komuna; dhe
- Te kontrata “Furnizim, montim dhe servisim të nxemjeve qendrore në shkollat fillore dhe të mesme të komunës” inicimi i procedurave ishte bërë në mungesë të projektit ekzekutiv. Si pasojë e mungesës së projektit ekzekutiv, me rastin e hartimit të paramasës dhe paralogarisë, komuna nuk kishte përcaktuar pozicione të matshme dhe të qarta.

Rreziku Nënshkrimi i kontratave në mungesë të projektit ekzekutiv rritë rrezikun e pranimit dhe menaxhimit jo adekuat të punimeve. Gjithashtu parregullsitë e identifikuar mund të reflektojnë edhe me punë shtesë dhe pagesa të parregullta apo vlerë të dobët për para.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim ku proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive për të përcaktuar se pse kanë ndodhur dështimet dhe pse nuk është aplikuar mbikëqyrja e përshtatshme. Më pas të merren veprimet adekuate për të siguruar se hartimi i projekteve behet para inicimit të procedurave tenderuese.

Çështja 12 - Hyrja në obligime kontraktuale pa mbulesë buxhetore

E gjetura Në vitin 2017, obligimet kontraktuale të komunës ishin më të larta se sa mjetet e ndara me ligjin për ndarjet buxhetore, që është në kundërshtim me nenin 9.3 të LPP-së. Kjo është identifikuar në dy kontrata, të "Ndërtimi i shkollës fillore Gjergj Kastrioti në Llozicë" dhe "Ndërtimi i ujësjetës në fshatin Pagarushë", të cilat shuma e ndarjeve buxhetore për tri vite ishte 280,000€, ndërsa vlera e kontratave të lidhura 754,521€, me deficit të fondeve për 474,521€. Kjo për shkak të planifikimit jo adekuat të komunës.

Rreziku Hyrja e komunës në kontrata, pa zotimin e mjaftueshëm paraprak të fondeve, dhe të pa parashikuar në kornizën afatmesme buxhetore, rritë rrezikun e vonesave në realizimin e këtyre projekteve apo rrezikun për mos përfundimin e plotë të tyre. Për më tepër, kjo shkakton vështirësi buxhetore dhe rritje të obligimeve për vitet vijuese apo edhe përballje me drejtësinë.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të rrisë kontrollin tek kontraktimet për të siguruar që asnjë kontratë nuk nënshkruhet pa siguruar fondet e nevojshme dhe bërë zotimin për realizimin e saj. Zotimet afatgjata duhet të harmonizohen me dinamikën e projekteve dhe të planifikohen me Kornizën Afatmesme Buxhetore të komunës.

Çështja 13 - Dobësi në planifikimin e buxhetit për investime kapitale

E gjetura Në 24 pagesa të testuara, në vlerë totale 279,072€, kemi identifikuar se komuna për mbulimin e tyre ka përdorë fondet nga projektet tjera planifikuara. Kjo është në kundërshtim me ligjin e buxhetit të aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sipas të cilit mjetet të përdoren vetëm për qëllimin e destinuar.

Rreziku Përdorimi i fondeve për qëllime tjera, përveç që është në kundërshtim me ligjin e buxhetit rrezikon që të devijohen projektet e realizuara në raport me ato të planifikuara në kuvendin komunal, në të cilin janë diskutuar dhe aprovuar prioritetet e qytetareve.

Rekomandimi 13 Kryetari të siguroj se janë marrë masat që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit, apo nëse paraqitet nevoja për ndryshim të projekteve, kjo të realizohen nëpërmjet propozimit dhe aprovimit nga kuvendi komunal duke siguruar paraprakisht aprovimet e duhura në bazë të rregullave.

3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale. Sipas raportit të zyrës së prokurimit janë nënshkruar 57 kontrata nga 75 të planifikuara apo 76 %.

Çështja 14 - Ndarje e tenderëve dhe planifikimi jo i plotë

E gjetura Numri i madh i prokurimeve të realizuara përmes procedurave me vlerë minimale, është tregues i dobët i planifikimeve të prokurimit duke iu shmangur aplikimit të procedurave të hapura. Për blerje të njëjta dhe me operatorë të njëjtë, janë aplikuar procedura të prokurimit disa herë gjatë vitit, si:

- Për servisimin e automjeteve, komuna kishte lidhur 12 kontrata (11 me procedura minimale) në vlerë 32,929€⁶. Për me tepër nga gjithsej kontratat, gjashtë janë lidhur me të njëjtin operator ekonomik;
- Për furnizimin me goma janë lidhur katër kontrata përmes procedurave me vlera minimale, tri prej të cilave më të njëjtin operator;
- Për blerjen e tonerëve komuna ka lidhur dy kontrata në vlerë totale 9,121€ (8,207€ dhe 914€); dhe
- Për furnizim me zhavorr, gjithashtu kanë lidhur dy kontrata në vlerë 14,030€ (8,300€ dhe 5,730€).

Rreziku Blerjet e shpeshta dhe me OE të njëjtë, paraqet mundësinë e favorizimeve të OE të caktuar. Kjo mund të ndikojë që buxheti të shpenzohet në mënyrë joefikase, duke qenë se blerjet në këtë mënyrë mund të bëhen me çmime më të larta dhe kualitet më të dobët.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet t'i kushtoj rëndësi më të madhe planifikimit të prokurimeve dhe të siguroj se njësitë kërkuese do t'i analizojnë me kohë nevojat për blerje/furnizime dhe të njëjtat të jenë pjesë integruese e Planit vjetor të prokurimit. Praktikrat e prokurimit përmes procedurave të hapura, nxitin konkurrencën dhe mundësojnë nxjerrjen e çmimeve dhe cilësisë më të mirë nga tregu. Kësisoj, fondet do të shpenzohen në mënyrë më efektive, efikase dhe ekonomike.

⁶ Vlerat e kontraktuara: 418€, 332€, 951€, 319€, 720€, 322€, 29,867€, 858€, 790€, 626€, 357€, 402€.

Çështja 15 - Pasoja e pagesave përmes vendimeve gjyqësore

- E gjetura** Për shkak se komuna nuk i kishte kryer pagesat me kohë dhe ndërprerjes së një anshme të marrëdhënies së punës, sipas vendimeve gjyqësore, nga Thesari janë ekzekutuar 93,638€. Si pasojë, pagesat për punonjësit e arsimit janë 42,032€ dhe pagesat për faturat për mallra shërbime dhe investime kapitale janë 37,089€ me që rast janë paguar edhe shpenzime shtesë në vlerë 14,517€ (për interesin 5,531€, si shpenzimeve të procedurave gjyqësore dhe të përmbarimit 8,986€).
- Rreziku** Shumat e ekzekutuara të pagesave në bazë të vendimeve gjyqësore krijojnë shpenzime shtesë duke reflektuar në prishjen e bilancit buxhetor dhe rrezikon mos realizim të projekteve të planifikuara dhe zvogëlim të fleksibiliteti në shpenzimet e komunës.
- Rekomandimi 15** Kryetari duhet të siguroj se do të bëjë një planifikim të mirëfilltë të buxhetit, duke forcuar disiplinën financiare për kryerjen e pagesave me kohë dhe marr masat e duhura për menaxhimin e duhur të obligimeve si dhe evitimin e shpenzimeve shtesë.

Çështja 16 - Kodifikim i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate

- E gjetura** Komuna në 11 raste pagesat për mallra dhe shërbime në vlerë 7,611€, shpenzimet janë regjistruar në kodet e gabuara në raport me planin kontabël të aprovuar nga Thesari/MF. Si pasojë informatat e prezantuara nuk ofrojnë të dhëna të sakta për shfrytëzuesin.
- Rreziku** Pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate ndikon në prezantimin e shpalosjeve jo të sakta të këtyre shpenzimeve sipas kodeve dhe natyrës duke vështirësuar shfrytëzimin e drejt të informatave financiare për vendimmarrësit dhe përdoruesit tjerë.
- Rekomandimi 16** Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e sistemit të kontrollit në këtë fushë që planifikimi buxhetor i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve adekuate si dhe pagesat të regjistrohen në kodet përkatëse sipas natyrës në përputhje me planin kontabël të aprovuar nga Thesari/MF.

3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna e Malishevës ka bërë përmirësime të dukshme sa i përket regjistrimit të pasurive komunale sipas rekomandimit dhe këshillave të dhëna vitin e kaluar dhe fazën e ndërmjetme duke evidentuar dhe përmirësuar regjistrat e pasurive për; 12 objekte të qendrave të mjekësisë familjare të cilat janë evidentuar, “Rregullimi i ndriçim publik” është regjistruar si projekt i përfunduar (figuronte si investim në vijim) dhe kishte hequr nga regjistri pagesat që nuk i takonin investimeve por mirëmbajtjes rutinore.

Çështja 17 - Dobësi në menaxhimi i pasurive më vlerë nën 1,000€

E gjetura Komuna nuk ka hartuar rregulla dhe procedura të brendshme për menaxhimin e pasurive, siç kërkohet me rregulloren për menaxhimin pasurisë nr 02/2013 neni 4.1. Për me tepër, tek shënimi i pasurive jo financiare në posedim të organizatës buxhetore, komuna kishte prezantuar të dhënat e prezantuara nga një evidencë e brendshme në excel, e cila nuk ofron siguri se janë përfshirë të gjitha pasuritë (nën 1,000€). Kjo ishte pasojë e mungesës së zyrtarit të pasurisë dhe mosfunksionimit të sistemit e- pasuria.

Rreziku Mungesa e rregullave të brendshme, si dhe në mungesë të sistemit e-pasuria, vështirësohet menaxhimi i pasurisë, si dhe nuk përmbushë kërkesat ligjore për raportim të drejtë financiar. Për me tutje shkakton rrezikun për humbjen apo tjetërsimin e pasurisë.

Rekomandimi 17 Kryetari duhet të sigurojë se kërkesat ligjore për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë më vlerë nën 1,000€ të përmbushen në tërësi.

3.10 Të arkëtueshmet

Struktura e llogarive të arkëtueshme përbëhet kryesisht nga: tatimi në pronë, taksat e aktivitetit të biznesit dhe qiratë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.11 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 265,630€, që krahasuar me vitin paraprak (54,000€) janë rritur për 211,630€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Komuna.

Çështja 18 - Menaxhimi i dobët i obligimeve

E gjetura Rritja e obligimeve krahasuar me vitin e kaluar pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të Komunës e cila është bartur për tu paguar në vitin e ardhshëm. Përveç kësaj ne kemi gjetur se:

- Në shtatë raste faturat e pranuar nuk janë evidentuar në librin e protokolimit të faturave siç kërkohet me nenin 24.1.3 të Rregullës Financiare 01-2013 MF - Shpenzimin e parasë publike;
- Komuna nuk ka raportuar në MF obligimet apo faturat e papaguara për muajin shtator 2017 siç kërkohet me nenin 5 Rregullës Financiare 02-2013 të MF - Raportimi i obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore; dhe
- Në një rast fatura e papaguar për shërbimet e telefonisë mobile për muajin dhjetor të vitit 2017, në vlerë 7,692€ nuk është përfshirë në regjistrin e obligimeve, duke nënvlerësuar obligimet për këtë vlerë.

Rreziku Mungesa e protokolimit të faturave me rastin e pranimit të tyre, si dhe mos raportimi i rregullt dhe i plotë i tyre, rritë rrezikun e pagesës së dyfishtë, ose mos pagesës së tyre të cilat më pas mund të jenë subjekt i pagesës për mes vendimeve gjyqësore. Po ashtu rritja e obligimeve paraqet vështirësi buxhetore në vitet në vijim.

Rekomandimi 18 Kryetari duhet të forcoj kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara. Fillimisht, duhet të siguroj mbajtjen e një libri të protokollit, ku do të regjistrohen dhe protokollohen të gjitha faturat e pranuar. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017, ka rezultuar me 13 rekomandime. Komuna kishte përgatitur planin e veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna, si dhe kishte diskutuar raportin e auditimit në Kuvendin Komunal Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, dy rekomandime janë zbatuar, katër të tjera janë në proces dhe shtatë rekomandime nuk janë zbatuar ende.

Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe dymbëdhjetë 12 rekomandime (një i zbatuar, katër në proces dhe shtatë të pa zbatuara). Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 19 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga vitet paraprake

E gjetura Për shkak të menaxhimit të dobët të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të nga ZKA, vetëm një numër i vogël i rekomandimeve ishin zbatuar, duke përfshirë edhe ato të bartura nga viti 2015. Komuna nuk aplikon ndonjë masë apo aktivitet të shtuar për zbatimin e rekomandimeve të ofruara nga auditori.

Moszbatimi i rekomandimeve ka rezultuar me dobësi të vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit në sistemet financiare kyçe, si me:

- Keq-klasifikime të shpenzimeve;
- Dobësi në menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve;
- Menaxhimi jo i duhur i obligimeve ndaj furnitorëve; dhe
- Dobësi në qeverisjen e përgjithshme, mungesë të procesit të raportimit dhe llogaridhënies menaxheriale.

Rreziku Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve, vështirësi në menaxhimin e sfidave në përmbushjen e objektivave apo edhe në humbje financiare.

Rekomandimi 19 Kryetari duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive në sistemin qeverisës të komunës, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Pyetësi i vet-vlerësimit, i plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen mjaftueshëm në dëshmi.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të vitit të kaluar nuk ishte i kënaqshëm, për shkak se nga 13 rekomandimet e dhëna, vetëm dy ishin zbatuar plotësisht.

Komuna posedonte draft planin e integritetit (2017-2019) dhe Planin e vlerësimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (janar 2016) por mungonin planet tjera strategjike si: planet urbanistike, hapësinore, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj.

Auditimi i Brendshëm nuk kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme, për arsye të mos funksionalizimit të komitetit të auditimit dhe mos përmbushjes së plotë të planit vjetor të auditimit.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe një auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Çështja 20 – Funksionimi i dobët i NjAB-it

E gjetura Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me operacionet aktuale të NjAB-së, si:

- Statutet për NjAB-në nuk ishin hartuar;
- NjAB kishte planifikuar 10 auditime gjatë vitit 2017, mirëpo vetëm pesë prej tyre ishin realizuar. Megjithëse kjo njësi kishte kryer edhe dy auditime tjera me kërkesë të kryetarit;
- Aktivitetet e auditimit nuk kanë mbuluar mjaftueshëm aktivitetet e vitit aktual, mirëpo janë fokusuar kryesisht në vitin e kaluar, 2016; dhe
- Komiteti i Auditimit nuk ka funksionuar gjatë vitit 2017.

Këto rezultate pasqyrojnë mungesën e angazhimit të menaxhmentit në njohjen dhe maksimizimin e përfitimit të auditimit të brendshëm ose për të kërkuar siguri për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme.

Rreziku Mungesa e statutit vështirëson definimin e qartë të autoritetit, përgjegjësive dhe sistemin e funksionimit të këtyre njësive, derisa mos përmbushja e planit vjetor të auditimit zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e kontrolleve të brendshme. Fokusi në aktivitetet e viteve paraprake nga NjAB gjithashtu rritë rrezikun që sistemi i kontrollit të brendshëm të mos përmirësohet dhe të përsëriten gabimet e njëjta. Mos funksionimi i komitetit të auditimit ndikon në vlerësimin, cilësinë dhe mos fuqizimin e NjAB.

Rekomandimi 20 Kryetari duhet të sigurojë se janë përgatitur statutet për NjAB-në, për të përcaktuar qartë funksionimin e tyre, si dhe të sigurojë se NjAB do të të përmbushë planin vjetor dhe do të ketë në fokus të veçantë aktivitetet në vitin aktual. Po ashtu duhet të themelojnë një komitet të auditimit i cili do të ndihmojë aktivitetet operative në vazhdim, më fokus në zbatimin e rekomandimeve, në mënyrë që përfitimet nga auditimi i brendshëm të jenë sa më të larta.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 21 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Si pasojë e kontrolleve të dobëta menaxheriale, fusha e prokurimit dhe e financave është përcjellë me shumë parregullsi, përfshirë, vlerësimin e dobët të nevojave, mbikëqyrjen e pamjaftueshme, si dhe vonesat në pagesat fshirjen e obligimeve, të cilat nuk ishin trajtuar me kohë dhe në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit. Si rezultat i kësaj, disa prej projekteve nuk kanë filluar, ndërkohë që disa kontrata janë subjekt i shqyrtimeve gjyqësore. Menaxhmenti nuk posedon analiza të rregullta për ecuritë buxhetore, nuk rishqyrton planin e prokurimit dhe nuk ka raporte të rregullta për aktivitetet operative.

Komuna gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Pra nuk ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së dhe komuna nuk ka strategji për menaxhimin e rrezikut, dhe as që përgatitë ndonjë raport për menaxhimin e tyre.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 21 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2016	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	Kryetari duhet të siguroj se çështjet e theksuara në opinionin e auditimit do të trajtohen me kujdes dhe do të ndërmerren të gjitha veprimet që të njëjtat të adresohen në PFV 2017. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabimet.			Nuk janë marrë masa.
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të siguroj se do të zbatohet një çasje e përmirësuar në hartimin dhe zbatimin e planit të veprimit, duke marrë me efikasitet të gjitha veprimet sipas afateve kohore dhe prioritetëve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i këtij plani duhet të bëhet të paktën çdo tremujor si dhe të zbatohet një proces rigoroz i llogaridhënies në rast të mos realizimit të tij.		Komuna kishte përgatitur planin e veprimit dhe raporti ishte diskutuar në Kuvendin Komunal, mirëpo niveli i zbatimit të rekomandimeve ishte shumë i ulët.	
2.2 Pyetësori i vetëvlerësimit të komponentëve të MFK-së	Kryetari duhet të përshpejtoj finalizimin e planit strategjik, të hartoj listën e rreziqeve dhe të bëj monitorimin në baza të rregullta të progresit në fushën e investimeve kapitale, për t'u siguruar se objektivat strategjike dhe operative janë duke u arritur. Njësia e auditimit të brendshëm duhet të përfshihet në procesin e rishikimit për ta konfirmuar cilësinë dhe saktësinë e listës kontrolluese.		Plani strategjik është në proces të finalizimit, mirëpo lista e rreziqeve ende nuk është hartuar.	

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike	Kryetari duhet të hartoj planet strategjike të zhvillimit dhe të vendos objektiva të qarta në gjithë sektorët e komunës, si dhe të njëjtat të monitorohen në mënyrë sistematike, për të vlerësuar planifikimet fillestare dhe progresin në arritjen e objektivave në periudhat e caktuara.		Plani strategjik i zhvillimit është përfunduar dhe dërguar në MMPH, mirëpo i njëjti është kthyer me vërejtje. Ndryshimet mbetet të përmirësohen dhe të dërgohen në kuvendin komunal për miratim.	
2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Për të përmirësuar procesin e raportimit dhe llogaridhënies, Kryetari duhet të sigurojë se brenda një periudhe të përshtatshme, është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ nga ana e Drejtorive të administratës komunale.			Nuk janë marrë masa.
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se NJAB do të të përmbushë planin vjetor dhe do të ketë në fokus të veçantë aktivitetet në vitin aktual. Kontributi i tij duhet të jetë më produktive përmes raporteve kualitative. Statuti i NJAB dhe i komitetit të auditimit duhet të hartohet dhe të aprovohet nga menaxhmenti, në mënyrë që roli i AB të jetë më i qartë. AB dhe Komiteti i Auditimit të jenë më aktive në fushëveprimin e tyre.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Për të shmangur ndikimet e përmendura më lart, Kryetari duhet të përmirësojë procesin e verifikimit vjetor të pronave dhe të sigurojë se verifikimi i pronave komunale, bëhet në baza të rregullta vjetore, dhe sipas kuotave të përcaktuara me ligj.			Nuk janë marrë masa.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të forcoj kontrollet në menaxhimin e kontratave dhe të certifikimit, dhe të siguroj se certifikimi i pagesave do të bëhet vetëm pasi të jenë pranuar raporte të qarta të cilat konfirmojnë pranimin e mallrave dhe shërbimeve sipas kontratës.		Komuna ka marrë masa për përmirësimin e kontrolleve, mirëpo edhe me tutje ne kemi identifikuar parregullsi të cilat janë raportuar.	
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të siguroj që në rastet e angazhimit të punëtorëve për shërbime të veçanta të aplikohen procedura të thjeshta të rekrutimit.			Nuk janë marrë masa.
3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj se dispozitat e Rregullores së brendshme komunale për ndarjen e subvencioneve zbatohen me konsistencë në të gjitha rastet, dhe për shumat e subvencioneve mbi 1,000€, të vendos Kuvendi Komunal.			Nuk janë marrë masa.
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se procedurat e prokurimit për projekte kapitale të zhvillohen në pajtim me ligjet në fuqi.	Po		
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet që të inicioj procesin e hartimit të rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare si dhe përdorimin e sistemit të e-pasurisë, sipas kërkesës së rregullores 02/2013 Për menaxhimin e pasurive jo financiare.			Nuk janë marrë masa.
3.2.2 Te arkëtueshmet	Kryetari duhet të sigurojë inicimin e një procesi të rivlerësimit, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për inkasim, dhe të propozoj masa efikase, duke mos i përjashtuar edhe masat administrative.	Po		

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna për vitin 2015	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet që kanë ndikuar në Theksim të çështjes. Është e nevojshme që të ndërmerren veprimet e duhura për t'i adresuar shkaqet për mos regjistrim të duhur të shpenzimeve në kategoritë adekuate.			Nuk janë marrë masa.
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin të plotë rekomandimeve, që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara.		Komuna kishte përgatitur planin e veprimit dhe raporti ishte diskutuar në Kuvendin Komunal, mirëpo niveli i zbatimit të rekomandimeve ishte shumë i ulët.	
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Një rol ndihmës në ngritjen e cilësisë dhe konfirmimit të pohimeve në pyetësorin e vetëvlerësimit, mund të ofroj auditimi i brendshëm përmes rishikimit përfundimtar.		Plani strategjik është në proces të finalizimit, mirëpo lista e rreziqeve ende nuk është hartuar.	
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se pas hartimit të një liste të rreziqeve me nivelet përkatëse, përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut është deleguar tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësisë do të menaxhoj dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi mbarëvajtjen e procesit.			Nuk janë marrë masa.
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për mënyrën e tanishme të llogaridhënies dhe të kërkesave për raportim të vendosura në drejtoritë e komunës dhe të zbatoj forma më praktike për arritjen e objektivave të synuara.			Nuk janë marrë masa.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të rishikojë nevojën që planet e auditimit të brendshëm të përshtaten me kërkesat që auditimi i brendshëm të ndjekë aktivitetet gjatë vitit aktual dhe të propozoj masa përmirësimi. Gjithashtu, Komiteti i Auditimit duhet të jetë shumë më aktiv në mbikëqyrjen, ngritjen dhe fuqizimin e rolit të auditimit të brendshëm.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike dhe janë identifikuar barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Kryetari duhet të siguroj planifikim të të hyrave të bazuar në parametra real, dhe të njëjtat të përshtaten me planet për investime kapitale, ashtu siç janë aprovuar me buxhet.		Me gjithë përmirësimet e bëra, mbetet sfidë planifikimi më i mirë i të hyrave dhe progresi në shpenzimin e mjeteve tek kategoria e investimeve kapitale.	
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të inicioj një analizë të plotë pse janë aplikuar praktika të dobëta të prokurimit në këto raste dhe të zbatojë kontrole të shtuara të cilat sigurojnë se: prokurimet i reflektojnë nevojat; specifikacionet e tenderit i reflektojnë kërkesat aktuale; dhe furnizimet i reflektojnë kërkesat e drejtorive. Në përgjithësi, kontrollet e prokurimit duhet që dukshëm të forcohen.		Me gjithë përmirësimet e bëra, kontrollet në proceset e prokurimit duhet të forcohen edhe me tutje.	
3.4 Prokurimi	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se njësitë kërkuese bëjnë një analizë të detajuar të vlerësimit të nevojave duke siguruar se në specifikacionin teknik nuk përfshihen pozicione të cilët janë të panevojshëm.			Nuk janë marrë masa.
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari të sigurojë se të gjitha marrëveshjet për bashkëfinancim janë subjekt i monitorimit efektiv. Po ashtu, në të ardhmen, kushtet e marrëveshjeve për bashkëfinancim duhet të specifikojnë qartë mënyrën dhe kohën e pagesave, dhe pagesat të bëhen vetëm pas konfirmimit se shërbimet/punët janë pranuar. Ne sugjerojmë që praktikat e pagesave në avans, të mos përsëriten.			Nuk janë marrë masa.

3.6.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari duhet ta shqyrtoj gjendjen e këtyre llogarive, të analizoj arsyet për akumulimin e këtyre shumave të konsiderueshme dhe të ndërmerr veprime efektive për maksimizimin e shkallës së inkasimit. Procesi i monitorimit sistematik të masave dhe politikave për rritjen e inkasimeve, duhet të jetë gjithashtu pjesë e shqyrtimeve të rregullta të menaxhmentit.	Po		
3.6.3 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të sigurojë se procedurat ekzistuese të përmirësohen për të konsoliduar plotësinë e obligimeve, duke zbatuar kërkesën që të gjitha departamentet komunale të përcjellin me kohë faturat e pa paguara tek departamenti i financave. Për trajtimin e detyrimeve kontingjente në koordinim me përfaqësuesin ligjor të Komunës, duhet të ndërmerr një rishikim të gjendjes së detyrimeve, për të përcaktuar prioritetin e pagesave, duke iu shmangur ekzekutimeve direkte nga MF.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca III: Komentet e komunës në gjetjet e raportit të auditimit

Të gjeturat/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e OB-së në rast të mospajtimit	Pikëpamjet e ZKA-së
Çështja 1: Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes	Jo	Pas pranimit të draft-raportit të auditimit të PVF 2017, për Komunën e Malishevës, shohim se opinionin është i kualifikuar me theksim të çështjes. Prandaj ne si menaxhment i Komunës nuk jemi të kënaqur. E aq më tepër pasi që si fakt për opinionin të kualifikuar është marrë keq-klasifikimi në vlerë totale prej 178,035€. Kjo si pasojë e asaj që ne si komunë nuk po kemi mundësi që vet ti përcaktojmë (planifikojmë) pesë kategoritë ekonomike ashtu siç kemi nevojë. Ne kemi nevojë për rritjen e Mallra dhe shërbimeve, Shpenzimeve komunale, subvencioneve etj. shih KAB-2017-2019 dhe 2018-2020, pasi që çdo vit shtohen objekte të reja si shkolla, ambulanca, objekte komunale etj. kurse me shpenzime të njëjta të përcaktuara nga ministria e financave është e pa mundur kryerja e aktiviteteve komunale. Prandaj keq-klasifikimet janë të pashmangshme.	Opinionin i auditimit është kompetencë e Auditorit të Përgjithshëm dhe jepet në përputhje me SNISA-t. Te Komuna e Malishevës keq-klasifikimet ishin materiale, andaj ne kemi kualifikuar opinionin e auditimit.
Çështja 2: Niveli i ulët i realizimit të të hyrave	Jo	Komuna ka bërë analiza mjaft të përafërta gjatë planifikimit të të hyrave vetjake, por kufirin përfundimtar e ka caktuar ministria e financave pavarësisht nga vërejtjet tona për vështirësitë dhe pamundësinë e arritjes së atij kufiri. Megjithatë të hyrat janë realizuar 58.51 e jo 52% .	Buxheti final sipas SIMFK-së ishte 1,097,142€ ndërsa të hyrat të cilat komuna i kishte pranuar janë 572,435€ apo 52%. Në këtë pjesë nuk janë përfshirë të hyrat indirekte të cilat grumbullohen dhe raportohen nga Institucionet e Nivelit Qendror.
Çështja 3: Parregullsi në menaxhimin e tatimit në pronë	Jo	Sa i përket verifikimit të objekteve (pronave), Komuna e Malishevës, zyra e tatimit në pronë ka kryer 2438 verifikime të pronave në terren që përbën 70% e masës së kërkuar me ligj, si dhe ka bërë verifikime, lexim nga dokumentet burimore të 693 pronave si dhe 1019 modifikime të elementeve të tatimpagueseve. Në total verifikime nga të dy burimet janë rreth 4150 verifikime të objekteve që përbën mbi 1/3 e pronave të tatimuara.	Sipas raportit vjetor që iu është ofruar auditorit, nga menaxheri i zyrës komunale të tatimit në pronë, komuna kishte verifikuar 2438 prona apo 20.50% nga 11,890 prona të regjistruara në regjistrin e tatimit në pronë.

Çështja 8: Mangësi në furnizimin me derivate	Jo	Kriter për dhënien e kontratës ka qenë çmimi më i ulët, dhe iu është dhënë kompanisë sipas këtij kriteri me çmimin e premiumit për 0.001€ për litër. Komuna posedon dokumentin në bazë të të cilit kompania ka kalkuluar çmimin për pagesën e audituar.	Komuna nuk ka asnjë dokument nga një palë e tretë që verifikon çmimin e berzës për furnizim me derivate.
Çështja 10: Dobësi në ndarjen e subvencioneve	Pjesërisht	Me shoqatën e bizneseve të Malishevës, Kryetari ka të nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në vlerë prej 7,600€ e jo me vendim.	Kryetari sipas rregullores komunale ka të drejtë ndarje të subvencioneve në vlerë deri në 1,000€. Kryetari ka anashkaluar aprovimin e nevojshme të kuvendit komunal duke e subvencionuar shoqatën e bizneseve përmes marrëveshjes me 7,600€.
Çështja 11: Inicimi i procedurave të prokurimit pa plan ekzekutiv	Jo	Tek kontrata ndërtimi i shkollës fillore në fsh. Llozicë, Komuna posedon projektin, që i përgjigjet lokacionit ku është duke u ndërtuar shkolla. Dmth që Komuna ka iniciuar procedura të prokurimit me projekt detal të ndërtimit. Tek furnizimi, montimi dhe servisimi i nxemjeve në shkollat fillore dhe të mesme të Malishevës, inicimi i procedurave është bërë me para masë dhe paralogari të bazuar në kërkesë të njësisë kërkuese (DKA) ku janë të përcaktuara qartë të gjitha shkollat ku duhet të bëhet furnizimi dhe servisimi i nxemjeve qendrore.	Rekomandimi ynë qëndron, LPP kërkon që për çdo projekt pune, OB duhet që të hartoj projekt ekzekutiv të veçantë. Komuna e ka përdorur projektin e një shkolle tjetër pa bërë adaptimet e nevojshme. Si pasojë e mungesë së një projekti veçantë për ndërtimin e këtij objekti, komuna është detyruar të bëjë aneks-kontratë për realizimin e punëve. Me tutje LPP kërkon që para inicimit të procedurave të prokurimit, OB të ketë projekt ekzekutiv. Komuna edhe në këtë rast nuk ka pasur projekt.

Shtojca IV: Letër konfirmimi



KOMUNA E MALISHEVËS

REPUBLICAN BUREAU OF AUDITING
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
Zyra e Auditimit të Përgjithshëm

21.06.2018
01/930

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Malishevës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem pjesërisht me të gjeturat dhe rekomandimet dhe ju dërgoj komentet tona në formatin Shtojca III; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetar i Komunës
z.Ragip Begaj

Datë: 21.06.2018
Malishevë